

VENDIM
Nr. 396, datë 13.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 687, DATË 22.11.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE,
QË DO T’U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... në masën 1.30 ...” zëvendësohen me “... në masën 1.20 ...”.

2. Ngarkohet ERE për përcaktimin e çmimit të aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama